

VENDIM
Nr. 559, datë 3.7.2013

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE BASHKIMIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRIVE “ENDI -E” SHPK, DHE “EKO A2” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “PRELLË 1” DHE “PRELLË 2””, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 1159, DATË 13.8.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes “Për disa ndryshime dhe shtesa në kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “ENDI -E”, sh.p.k., dhe “EKO A2”, sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Prellë 1” dhe “Prellë 2””, miratuar me vendimin nr. 1159, datë 13.8.2008 të Këshillit të Ministrave.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha